

1 E mërkurë, 28 tetor 2020

2 [Paraqitje e Parë e Mëtejshme]

3 [Seancë e Hapur]

4 [I akuzuari hyn në sallën e gjyqit]

5 --- Fillon në orën 15.00

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirëdita të gjithëve
7 brenda dhe jashtë sallës së gjyqit.

8 Zonja Sekretare -- Zotëri Sekretar, ju lutem paraqitni
9 çështjen.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëdita i nderuar
11 Gjykatës. Lënda KSC-BC-2020-05, Prokurori kundër Salih
12 Mustafës.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit i nderuar
14 Sekretar.

15 Tani do t'u kërkoj palëve dhe pjesëmarrësve të
16 prezantohen. Do të filloj me Zyrën e Prokurorit të
17 Specializuar. Urdhëroni.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita. Zyra e Prokurorit të
19 Specializuar sot përfaqësohet nga Prokurori i Specializuar
20 vetë, Jack Smith; unë Cezary Michalczuk, prokuror; dhe Silvia
21 D'Ascoli, ndihmësprokurore; si dhe Clare Lawson që është
22 ndihmësjuriste në ZPS.

23 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Tani i drejtohem
24 Mbrojtjes.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita i nderuar Gjykatës. Unë

1 jam Julius von Bone, mbrojtësi i z. Mustafa.

2 GJYKATËSI GUILLLOU: [Përkthim] Faleminderit.

3 Për hir të procesverbalit theksoj që i pranishëm është
4 edhe z. Mustafa. Unë jam Nicolas Guillou, gjykatës i
5 Procedurës Paraprake në këtë çështje.

6 Më 19 tetor caktova seancën e sotme për dy qëllime:
7 E para, për të lejuar z. Mustafa të vetëdeklarohet për fajësi
8 ose pafajësi lidhur me akuzat e ngritura kundër tij dhe të
9 konfirmuara nga gjykatësi i Procedurës Paraprake, dhe e dyta,
10 për të mbajtur edhe një Konferencë të Ecurisë së kësaj
11 Çështjeje.

12 Do të filloj me vetedeklarimin e z. Mustafa.

13 Z. Mustafa, gjatë Paraqitjes së Parë më 28 shtator, ju
14 informova që duhet të vetëdeklaroheni fajtor ose i pafajshëm
15 lidhur me akuzat e ngritura kundër jush në aktakuzën e
16 konfirmuar. Në ushtrimin e së drejtës suaj ju u shprehët,
17 atëherë pra, në seancën e Paraqitjes së Parë, se nuk
18 dëshironit të vetëdeklaroheshit lidhur me fajësinë ose
19 pafajësinë. Ju rikujtoj se në bazë të rregullës 92, ju duhet
20 të vetëdeklaroheni për fajësi ose pafajësi brenda 30 ditësh
21 nga Paraqitja juaj e Parë, dhe në qoftë se këtë nuk do ta bëni
22 atëherë unë do të bëjë vetëdeklarim -- deklaram në emrin tuaj
23 për pafajësi. Sot kalon afati 30-ditësh.

24 Përpara se të vazhdoj, do ta pyes Mbrojtësin e të
25 akuzuarit në qoftë se e ka marrë paketën e materialeve të

1 nxjerra nga Prokurori që e kishte afatin deri më 23 tetor, në
2 përputhje me Vendimin tim Kornizë për Nxjerrjen e Provave dhe
3 Materialeve të Tjera, të lëshuar më 9 tetor.

4 Z. Von Bone urdhëroni.

5 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
6 Gjykatës.

7 I kam marrë këto materiale në rregull. Çështja e
8 përkthimit është një çështje që do ta trajtoj pak më vonë në
9 Konferencën e Ecurisë së Çështjes, por për momentin mund të
10 them që i kam marrë këto dokumente. Gjithashtu dua të them se
11 z. Mustafa do të bëjë një deklaratë përpara se të
12 vetëdeklarohet për fajësi ose pafajësi.

13 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Mustafa, pas pak do
14 t'ju kërkoj që të vetëdeklaroheni për fajësi ose pafajësi
15 lidhur me secilën pikë të aktakuzës së konfirmuar.

16 Dua t'ju rikujtoj se ky është një vendim mjaft i
17 rëndësishëm. Në qoftë se dëshironi të vetëdeklaroheni fajtor
18 për një apo më shumë pika, atëherë procedurat lidhur me ato
19 pika do të kalojnë direkt te një Trup Gjykues. Nuk do të
20 prezantohen pra, prova dhe nuk diskutohet fajësia ose
21 pafajësia juaj. Në atë rast, Trupi Gjykues thjesht do të
22 përcaktojë në qoftë se deklarimin e fajësisë e keni bërë në
23 bazë vullnetare, në qoftë se i kuptoni pasojat, dhe do të
24 kalojë direkt në përcaktimin e dënimit.

25 Ndryshe, në qoftë se do të vetëdeklaroheni i pafajshëm

1 lidhur me një apo më shumë pika të aktakuzës, atëherë do të
2 vazhdojnë procedurat paragjyqësore me qëllim përgatitjen e
3 kësaj çështje për gjykim para një Trupi Gjykses.

4 Në gjykim atëherë Trupi Gjykses do të marrë prova, do të
5 dëgjojë dëshmitarë dhe do të dëgjojë parashtrimet e palëve,
6 dhe më pas do të marrë vendimin në qoftë se Prokurori e ka
7 vërtetuar fajësinë tuaj jashtë dyshimit të arsyeshëm.

8 Tani do t'ju kërkoj që të vetëdeklaroheni për secilën
9 prej katër pikave në aktakuzën e konfirmuar. Ju rikujtoj se
10 këto akuza ju janë lexuar në Paraqitjen e Parë.

11 Z. Mustafa, përpara se të vetëdeklaroheni për fajësi ose
12 pafajësi, a dëshironi që edhe njëherë t'ju lexohen të gjitha
13 akuzat nga sekretarja e gjykatës sot?

14 Thjesht d.m.th., po ju pyes në qoftë se dëshironi t'ju
15 lexohen edhe njëherë akuzat. Pra, jo të vetëdeklaroheni tani,
16 por thjesht a doni që t'ju lexohen këto akuza edhe njëherë
17 sot.

18 Mikrofonin ju lutem.

19 I AKUZUARI: I nderuari z. Gjykatës, para se me u deklaru
20 për fajësinë apo pafajësinë time, me lejen tuaj unë do i kisha
21 thënë ca fjalë.

22 Aktakuzën nuk ka nevojë me ma rilexu për shkak se e kam
23 kuptu.

24 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në rregull. Atëherë,
25 sekretarja nuk do t'jua lexojë akuzat përpara se të

1 vetëdeklaroheni. Atëherë, tani mund të bëni deklaratën tuaj,
2 po ju lutem të jeni i shkurtër. Ju faleminderit.

3 I AKUZUARI: Faleminderit për fjalën z. Gjykatës.

4 I nderuari z. Gjykatës.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ngrihuni në këmbë njëherë
6 përpara sesa të filloni deklaratën z. Mustafa.

7 I AKUZUARI: I nderuari z. Gjykatës. Fillimisht ju
8 falënderoj për mundësinë që më dhatë për të shprehur atë që
9 mendoj dhe jam i bindur.

10 Dhoma të Specializuara të Republikës së Kosovës, z.
11 Gjykatës, zonja dhe zotërinj.

12 Pasi që jam qytetari i parë i Republikës së Kosovës i
13 nxjerr para kësaj Gjykate me një akuzë të konfirmuar, dua t'i
14 them ca fjalë, apo më mirë të them, dua të bëj një deklaratë.

15 Unë Salih Mustafa, ish-luftëtar i lirisë dhe ish-epror i
16 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës duke besuar thellë në betimin e
17 ushtarit të UÇK-së dhe moralin e bashkëluftëtarëve të mi, duke
18 qenë thellë i bindur se lufta për liri e pavarësi e UÇK-së ka
19 qenë e drejtë, e pashmangshme dhe e domosdoshme, sepse okupimi
20 i gjatë dhe regjimi nacional-shovinist dhe fashist me përmasa
21 gjenocidiale i Sllobodan Milosheviqit si dhe pas luftërave
22 pushtuese të përgjakshme të këtij kasapi në Kroaci dhe Bosnjë,
23 mua dhe popullit tim nuk na kishte lënë shumë zgjidhje, o të
24 përfundonim të përndjekur në kampet e refugjatëve në Evropën
25 Perëndimore, pa nder, pa atdhe e pa liri, ose të

1 organizoheshim në një rezistencë të gjithanshme që kulmoi me
2 luftën çlirimtare për liri, pavarësi e shtet demokratik.

3 I nderuar z. Gjykatës, duke besuar në moralin tim,
4 bindjet e mia dhe karakterin tim që kam ndërtuar përgjatë 34
5 vite të jetës sime në shërbim të atdheut, të rrugës drejt
6 lirisë, si dhe në shërbim të institucioneve demokratike të
7 shtetit tim, duke respektuar e nderuar gjithmonë shtetet mike
8 që ndihmuan lirinë tonë, duke qenë thellë i bindur se UÇK-ja
9 kurrë nuk ka qenë organizatë terroriste apo grup a bandë e
10 organizuar kriminale, por një ushtri çlirimtare e cila lindi
11 nga populli dhe e cila me shumë mund e sakrifica duke derdhur
12 edhe gjakun e vajzave edhe djemve më të mirë të kombit është
13 bërë gurthemel i lirisë sonë që sot ne e gëzojmë.

14 Duke dashur të besoj se këto Dhoma të Specializuarra nuk
15 do të influencohen nga politika, qoftë vendore apo
16 ndërkombëtare, po as nga interesa për qerime hesapesh të
17 individëve apo grupe të interesit. Duke dëshiruar që këtë
18 gjykatë armiqte e shtetit tim nuk do të mund ta përdorin
19 kundër republikës time dhe qytetarëve të saj. Duke i përbuzur
20 ata individë apo grupe individësh, qofshin ata vendorë apo
21 ndërkombëtarë, që për interesa të ngushta politike, pasurie
22 apo interesa të tjera të ulëta, po godasin themelet e lirisë
23 tonë, luftën e drejtë të UÇK-së dhe po tentojnë t'i kryqëzojnë
24 luftëtarët e lirisë duke bërë punën e Luciferit. Përderisa
25 lakmia dhe interesat e ngushta ua kanë turbulluar mendjet,

1 sytë ua kanë verbuar nga urrejtja dhe inatet, e shpirtin ia
2 kanë shitur djallit. Për këtë kategori nuk po gjej fjalë më
3 adekuate shpirtërore për të shprehur sesa fjalët hyjnore të
4 Jezu Krishtit në momentin e kryqëzimit kur thotë: "Fali o Zot
5 se nuk po e dinë çfarë po bëjnë".

6 I nderuar z. Gjykatës, duke të falënderuar për mundësinë
7 dhe për të këtë që ma dhe për t'u shprehur lirshëm, duke
8 besuar në drejtësi dhe vlera demokratike, shfrytëzova rastin
9 që nga kjo gjykatore t'i bëj thirrje deputetëve të Parlamentit
10 Evropian, deputetëve të Kosovës, politikanëve vendimmarrës të
11 shteteve evropiane, politikanëve të Kosovës, si dhe drejtësisë
12 evropiane, që të zgjojnë ndërgjegjen njerëzore, demokratike,
13 humanitare që kësaj Gjykate Speciale selektive -- s'po e
14 përkthen mirë -- që kësaj Gjykate Speciale selektive që në
15 analet e historisë dhe të drejtësisë evropiane ndërkombëtare
16 është e panjohur, t'ua zgjeroj kompetencat për të hetuar,
17 gjykuar dhe për të vënë drejtësi edhe për 1.392 fëmijë të
18 vrarë e të masakruar, për 16.000 viktima civile, për 20.000
19 motrat dhe nënat tona të dhunuara dhe të abuzuara seksualisht,
20 për kthimin dhe gjetjen e 1.500 bashkëqytetarëve të mi që ende
21 evidentohen të zhdukur, për qindra varreza masive të zbuluara
22 që nga Beogradi e deri në Rashkë të Serbisë, përmbi 450
23 masakra të ndodhura anekënd Kosovës, dhe për dëmet kolosale
24 materiale të shkaktuara mbi ekonomitë familjare por edhe
25 ekonominë shoqërore, të cilat i shkakttoi okupatori gjenocidial

1 nacional-fashist i Serbisë.

2 Sepse jam i bindur se pajtimi i popujve nuk arrihet duke
3 ia mprehur shpatat xhelatëve e viktimat duke i viktimizuar
4 edhe për së vdekuri. Por as paqja dhe prosperiteti demokratik
5 e evropëndimor në Ballkan nuk do të arrihet duke përkëdhelur
6 e mikluar trinomin autokratik klerofashit dhe
7 nacionalshovinist të përbërë nga Aleksandër Vuçiçi, Ivica
8 Daçiçi dhe Aleksandër Vulini, të cilët ishin aktorë aktivë në
9 regjimin e Milosheviçit dhe tani si derivat i atij regjimi
10 janë shndërruar në çetnikë sallonesh. Të cilët gjithashtu edhe
11 në ditët e sotme me politikat e tyre fashiste po godasin
12 lirinë dhe qytetarët e shtetit tim. Bashkëkombësit e mi në
13 Kosovës lindore e në Sanxhak po i bëjnë të vuajnë duke ua
14 mohuar edhe të drejtat themelore njerëzore, kurse në anën
15 tjetër po cenojnë të gjitha shtetet e Ballkanit që po
16 ndërtojnë demokraci perëndimore. Dhe në këtë mision po
17 përkrahen nga aleati i tyre tradicional djallëzor.

18 Duke shpresuar se kjo gjykatë do të prodhojë drejtësi dhe
19 vetëm drejtësi, edhe pse ende nuk e kam marrë aktakuzën e
20 pacensuruar dhe të gjitha shkresat e lëndës, ju siguroj z.
21 Gjykatës se në këtë betejë time ligjore me Prokurorinë para
22 kësaj Gjykate, në çdo rast dhe çdo herë do ta përdori të
23 vërtetën për të vërtetën dhe të drejtën.

24 Sot jam i gatshëm të deklarohem për pafajësinë apo
25 fajësinë time.

1 Faleminderit z. Gjykatës për fjalën. Faleminderit për
2 durimin për të më dëgjuar.

3 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z.
4 Mustafa.

5 Gjykata ju ka dëgjuar. Shumë prej asaj që thatë është
6 jashtë asaj pse jemi mbledhur sot këtu, dhe unë dua të
7 përqendrohem në arsyen pse jemi këtu.

8 Dëgjova në fund të deklaratës tuaj që doni të
9 vetëdeklaroheni i pafajshëm. Unë tani sipas procedurës do t'ju
10 pyes në lidhje me secilën pikë veç e veç. Do t'ju kërkoj
11 përsëri të ngriheni në këmbë ju lutem, dhe të vetëdeklaroheni
12 për secilën pikë.

13 Z. Mustafa, si vetëdeklaroheni lidhur me Pikën 1, ku
14 akuzoheni për krimin e luftës të ndalimit arbitrar?

15 I AKUZUARI: I pafajshëm z. Gjykatës.

16 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Si deklarojeni lidhur me
17 Pikën 2, ku akuzoheni për krimin e luftës të trajtimit mizor?

18 I AKUZUARI: I pafajshëm z. Gjykatës.

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Si deklarojeni lidhur me
20 Pikën 3, ku akuzoheni për krimin e luftës të torturës?

21 I AKUZUARI: I pafajshëm z. Gjykatës.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Dhe së fundi, si
23 deklarojeni lidhur me Pikën 4, ku akuzoheni për krimin e
24 luftës së vrasjes së paligjshme?

25 I AKUZUARI: I pafajshëm z. Gjykatës.

1 JYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Mustafa.
2 Mund të uleni.

3 Z. Mustafa, duke qenë se u vetëdeklaruat i pafajshëm
4 lidhur me të gjitha pikat, do të vazhdohet procedura paraprake
5 për nevojat e përgatitjes së çështjes për gjykim në përputhje
6 me rregullën 95. Këtu përfundon pjesa e parë e seancës së
7 sotme. Tani do të kalojmë në pjesën e dytë pra, në Konferencën
8 për Ecurinë e kësaj Çështjeje.

9 [Konferencë për Ecurinë e Çështjes]

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Në urdhrin për caktimin e
11 datës së seancës ishte përfshirë edhe një plan i ditës që
12 përfshinte pikat që dëshiroj t'i diskutoj sot me palët, përveç
13 atyre që kanë të ngrenë vetë palët.

14 Përpara se të kaloj në rendin e ditës, dua që të trajtoj
15 kërkesën e Prokurorit për rishqyrtimin e urdhrit për dorëzimin
16 e listës së nxjerrjes.

17 Kjo kërkesë ka të bëjë me Vendimin tim Kornizë për
18 Nxjerrjen e Materiale Lidhur me Çështjen të datës 9 tetor. Në
19 këtë vendim unë urdhërova Prokurorinë që ndër të tjera të bëjë
20 nxjerrjen e listave të dokumentacionit inkriminues. Pra, këtë
21 dokumentacion t'ia nxjerrë Mbrojtjes sipas rregullës
22 102(1)(b). Vendimi kornizë gjithashtu informonte Prokurorin
23 për vendimin tim për të kërkuar një version të këtyre listave.

24 Ngjashëm, më 19 tetor Prokuroria kërkoi që unë të
25 rishqyrtoj këtë pjesë të Vendimit Kornizë. Ndryshe, Prokuroria

1 kërkoj që unë të certifikoj çështjen për apel dhe të miratoj
2 efekt pezullues për urdhrin për dorëzimin e listës së
3 materialeve të nxjerra.

4 Për më tepër, pas zgjidhjes së kësaj çështjeje Prokurori
5 kërkoj që të dëgjohet lidhur me afatet që dalin nga kërkesat
6 në Vendimin Kornizë.

7 Më 23 tetor unë shkurtova këtë afat. Urdhërova Mbrojtjen
8 që të japë përgjigjen e vetë me shkrim deri dje, më 27 tetor,
9 ose sot me parashtrime gojore, në seancën e sotme. Gjithashtu
10 urdhërova Prokurorinë që të jepte kundërpërgjigjen e vetë sot
11 në këtë seancë apo deri nesër me shkrim.

12 Përpara se t'u jap fjalën palëve për të trajtuar çështjet
13 e paraqitura në këtë kërkesë, dua të them se kjo çështje nuk
14 është e re për procedurat në nivel -- penale në nivel
15 ndërkombëtar. Këto çështje kanë ndikim jo vetëm në detyrimet e
16 palëve por edhe në shpejtësinë e procedurave.

17 Z. Von Bone, shoh që nuk keni bërë parashtrime me shkrim
18 brenda afatit të dhënë. A doni që të bëni parashtrime gojore
19 në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë?

20 Z. VON BONE: [Përkthim] Po. Do të bëj parashtrime i
21 nderuar Gjykatës.

22 Ju faleminderit i nderuar Gjykatës. Mbrojtja ka marrë
23 shënim urdhrin e gjykatësit lidhur me listat. Urdhri juaq mban
24 datën 9 tetor dhe ka të bëjë me Vendimin Kornizë për Nxjerrjen
25 e Materialeve në këtë Çështje.

1 Mbrojtja gjithashtu ka marrë shënim kërkesën e
2 Prokurorisë për shqyrtimin e urdhrin lidhur me listat, ose
3 ndryshe, kërkesën e saj për apelimin e këtij urdhri.

4 Në fakt i nderuar Gjykatës, fjala apo tema e listave nuk
5 paraqitet në Ligj apo në Rregulloren e Procedurës dhe Provës.
6 Zyra e Prokurorit të Specializuar në kërkesën e vetë thotë që
7 gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e ka shqyrtuar kuadrin
8 ligjor përpara Dhomave të Specializuara lidhur me nxjerrjen e
9 materialeve dhe përgatitjen e çështjes.

10 ZPS-ja, apo Zyra e Prokurorit të Specializuar thotë se
11 gjykatësi kryesues ka gabuar në ushtrimin e diskrecionit të
12 tij sipas nenit 39 dhe rregullës 95(2)(b). ZPS-ja thotë që
13 rishqyrtimi është i domosdoshëm për t'iu shmangur padrejtësisë
14 duke përfshirë gabimet e panevojshme dhe të pariparueshme
15 lidhur me drejtësinë dhe shpejtësinë e këtyre procedurave.

16 Tani i nderuar Gjykatës, përpara se të kaloj në
17 parashtrimet e mia lidhur me atë çështje, dua të paraqes
18 mendimet e mia lidhur me mundësinë e apelit të urdhrin të
19 kundërshtuar. Në bazë të nenit 45 të Ligjit dhe rregullës
20 77(2) të Rregullores, kemi standardin e duhur të apelit. Në
21 apel duhet të bëhet fjalë për një çështje që do të ndikonte në
22 mënyrë të konsiderueshme mbi drejtësinë dhe shpejtësinë e
23 procedurave, të cilat për mendimin e gjykatësit kryesues duhet
24 -- merret një vendim i menjëhershëm nga Gjykata e Apelit.
25 Certifikimi për apel d.m.th., duhet të testohet për këtë

1 standard të veçantë.

2 Përveç kësaj është edhe e drejta e vetvetishme e
3 gjykatësit sipas nenit 39 të Ligjit. Neni 39 thotë se
4 gjykatësi mund të bëjë -- të nxjerrë urdhrat dhe vendimet e
5 nevojshme për sigurimin e përgatitjes së shpejtë dhe të duhur
6 të gjykimit. Për mendimin e Mbrojtjes, urdhri i gjykatësit të
7 Procedurës Paraprake duhet të shikohet dhe shqyrtohet në këtë
8 kontekst.

9 Mbrojtja beson se është pikërisht kjo çështje që është
10 paraparë nga gjykatësi i Procedurës Paraprake kur ka nxjerrë
11 atë urdhër. Nëse kjo është çështje gabimi në ushtrimin e të
12 drejtës së vetvetishme sipas nenit 39 të Ligjit, mbetet për
13 t'u vendosur. Por t'ju them sinqerisht i nderuar Gjykatës,
14 mendoj se palët munden dhe duhet të lejohen të bëjnë
15 parashtime lidhur me urdhrin duke qenë se një urdhër i tillë
16 iu parashtroi barrë të dyja palëve.

17 Kjo jo domosdoshmërisht do të thotë që kjo duhet të bëhet
18 përpara dhënies së urdhrit prej jush. Sipas nenit 79(1) të
19 Rregullores së Procedurës dhe Provave, gjykatësi mund të
20 rishqyrtojë vendimet e veta. Ky rregull sipas mendimit të
21 Mbrojtjes jep mundësinë për këtë kundërshtim aktual. Mendoj që
22 asnjëri nga pjesëmarrësit apo palët në këtë gjykim dëshiron të
23 ndodhë dublikimi i ndonjë materiali, sepse kjo nuk është
24 praktike në asnjë mënyrë dhe për asnjërën palë.

25 Unë në fakt kontaktova Prokurorinë për të marrë një

1 sqarim lidhur me listën edhe çfarë do të thotë kjo fjala
2 "listë" ose "tabelë". Një përshkrim i detajuar që është dhënë
3 kohëve të fundit, duket si një lloj liste apo tabele.

4 Për të qenë praktik, Mbrojtja propozon që palët pra, ZPS-
5 ja dhe Mbrojtja të merren vesh sesi duhet të duket një listë
6 dhe atë listë pastaj t'ia paraqesin gjykatësit të Procedurës
7 Paraprake. Kjo duhet të bëhet sa më shpejt që është e mundur
8 dhe me qëllim që të shihet në qoftë se rezultati përfundimtar
9 është në përputhje me idenë që ka gjykatësi i Procedurës
10 Paraprake lidhur me listën.

11 Besoj i nderuar Gjykatës, që rregulla 79(1) do të japë
12 mundësinë -- do t'ia japë mundësinë gjykatësit të Procedurës
13 Paraprake të rishqyrtojë urdhrin e vetë nën dritën e
14 parashtrimeve të palëve. Kjo mund të bëhet *proprio motu*.
15 Urdhri jo domosdoshmërisht duhet të rishqyrtohet, por thjesht
16 mund të përshtatet me udhëzime specifike se çfarë duhet të
17 përmbajë një tabelë ose listë e tillë.

18 Kaq kisha unë në emër të Mbrojtjes. Ju faleminderit i
19 nderuar Gjykatës.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Von
21 Bone.

22 Tani do t'ia jap fjalën Prokurorisë. Përpara se të
23 vazhdojmë do të thoja dy gjëra:

24 E para, lista apo listat nuk kanë vetëm për qëllim të
25 ndihmojnë Mbrojtjen, sepse përmbajnë informacion të

1 materialeve të paraqitura apo të dorëzuara, por gjithashtu e
2 ndihmon edhe Trupin Gjykses për të kuptuar më mirë se çfarë
3 përmban lista d.m.th., çfarë materialesh janë nxjerrë.

4 Tani i jap fjalën Prokurorit për parashtrimet e veta
5 lidhur me atë që tha z. Von Bone.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
7 Gjykatës. Për këtë pikë do të flasë kolegja ime znj. Lawson.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Urdhëroni znj. Lawson.

9 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
10 Gjykatës.

11 Dhomat e Specializuara kanë një regjim mjaft rigoroz dhe
12 unik të paraqitjes së nxjerrjes së materialeve që reflektohet
13 në Ligj dhe në Rregullore. Rregulla 109(c) është pjesë e këtij
14 kuadri dhe -- të nxjerrjes së materialeve.

15 Siç theksuat edhe ju i nderuar Gjykatës, kjo nuk është
16 një çështje e re që paraqitet vetëm në këtë gjykatë. Ne kemi
17 konsultuar dhe jurisprudencën e gjykatave të tjera me qëllim
18 që të marrim udhëzime sesi të veprohet lidhur me këtë pikë.
19 Megjithatë pyetja kryesore është sesi të zbatohet kjo
20 dispozitë e vetme pra, rregulla 109(c) përpara kësaj -- këtij
21 institucioni unik, dhe ajo që është me më rëndësi, në këtë
22 çështje konkrete.

23 Rregulla 109(c) kërkon kategorizimin për nevoja praktike.
24 Me anë të kësaj na jepet mundësia që të ndihmojmë gjykatën me
25 informacionin relevant që mund të ndihmojë.

1 Në fakt ajo që është praktike brenda kuptimit të
2 rregullës 109(c) ndryshon prej një çështje në tjetrën. Me
3 fjalë të tjera, një gjë që funksionon në një çështje jo
4 domosdoshmërisht funksionon në një çështje tjetër.

5 Sikurse aludoi edhe Mbrojtësi, zgjidhjet e mundshme janë
6 një mundësi. Ne kemi pasur biseda konstruktive lidhur me këtë
7 temë dhe ZPS-ja paraprakisht ia bëri të ditur Mbrojtjes
8 parashtrimet, natyrën e përgjithshme të parashtrimeve që ka
9 ndërmend t'i bëjë sot, sepse është, ju siguroj, edhe në
10 interesin tonë që të gjejmë zgjidhjen më praktike dhe më të
11 përshtatshme për këtë çështje.

12 Për interpretimin tonë të fjalës "praktike", kjo do të
13 thotë e drejtë dhe e përshtatshme në përputhje me kuadrin e
14 përgjithshëm të nxjerrjes së materialeve pa kompromentuar
15 shpejtësinë e procedurave.

16 Për sa i përket zyrës time, është fakt që ZPS-ja vepron
17 me një numër të vogël stafi. Edhe kur është në kapacitetin e
18 plotë ne kemi një staf të kufizuar për sa i përket çështjeve
19 ligjore. Nuk kemi sot këtu përfaqësues të ekipit ligjor. Nuk e
20 kemi luksin e mundësisë që të fokusohemi vetëm në një
21 procedurë. Stafi jonë duhet të caktohet edhe në lëndë të tjera
22 për ta ndarë barrën në mënyrë të barabartë.

23 Kur them "detyra prioritare", iu referohem funksioneve
24 thelbësore sipas kuadrit ligjor të cilat janë të domosdoshme
25 dhe të mandatuara për kryerjen e shpejtë të gjykimeve.

1 Është e dukshme nga kuadri ligjor që rregulla 109(c)
2 përmban një nivel fleksibiliteti rreth asaj se çfarë është
3 praktike dhe çfarë nuk është. Është një kategorizim praktik që
4 sqaron gjithë setin e kritereve që parashikohen në Rregullore.

5 Dhënia e një përshkrimi të detajuar kërkohet në fazën e
6 konfirmimit sipas rregullës 86, dhe ne jemi të kënaqur që kjo
7 e ndihmon gjykatësin e Procedurës Paraprake. Megjithatë, barra
8 tjetër e vazhdimit të paraqitjes së dokumenteve, sikurse tha
9 edhe Mbrojtja, është mjaft, mjaft e rëndësishme. Nuk është
10 praktike për ZPS-së që të mos jetë konsistente me shpejtësinë
11 e procedurave.

12 Në këtë rast konkret, përveç transkripteve të të
13 akuzuarit, materiali mbështetës i aktakuzës përmbante edhe
14 dëshminë e pesë dëshmitarëve së bashku me disa dokumente të
15 tjera. Edhe pse ZPS-ja ka bërë analizën dhe punën e duhur
16 gjatë hetimeve të saj, përgatitja e një përshkrimi të detajuar
17 kërkon punë të paktën prej gjashtë njerëzish dhe të paktën për
18 disa javë.

19 Sikurse u tha edhe në Konferencën e mëparshme, dokumente
20 të tjera të mbetura sipas rregullës 102(b) janë dyfishi i
21 atyre të parave dhe përfshijnë të paktën edhe 11 dëshmitarë të
22 tjerë.

23 Sikurse thashë më herët, rregulla 109, vlerësimi sipas
24 kësaj rregulle do të ndryshojë prej një çështje në tjetrën
25 përpara gjykatës -- kësaj gjykate.

1 Ti kthehem tani zgjidhjeve. Ne do të jemi fleksibil
2 brenda mundësive që i kemi.

3 Në kohën kur doli vendimi, gjykata nuk ka qenë në dijeni
4 të kategorizimit të materialit të nxjerrë që është bërë në
5 sistemin "Legal Workflow". Gjithsesi, përveç kësaj ne kemi
6 punuar për të nxjerrë propozime në alternativë lidhur me
7 formatin e listave që mund të ndihmojnë si Dhomën, si Trupin
8 Gjykues, ashtu edhe Mbrojtjen.

9 Në qoftë se ka edhe ndonjë gjë tjetër me të cilën mund ta
10 ndihmoj Dhomën, atëherë unë jam e gatshme ta bëj këtë. Në
11 qoftë se jo, atëherë ju faleminderit.

12 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë znj.
13 Lawson.

14 Z. Mustafa ky ishte debat pak a shumë teknik. Nuk e di në
15 qoftë se e kuptuat apo jo, sepse është një lloj debati
16 ndërmjet juristëve.

17 Ajo çfarë po diskutojmë këtu është se kur Prokuroria të
18 nxjerrë provat, që t'i zbulojë ato, t'i bëjë publike, si t'i
19 kategorizojë ato në një tabelë, në një listë e cila është e
20 kuptimtë për juve si i akuzuar. Dhe në qoftë se kemi të bëjmë
21 me prova të cilat janë të rëndësishme dhe për të cilat do të
22 duhen që të nxirren emra dhe detaje të tjera, si të bëhet ky
23 proces.

24 Pra, rreziku është që të kemi shumë prova të cilat i
25 dërgohen secilës prej palëve pa u shpjeguar, pa u

1 kategorizuar, dhe pastaj përfundojmë në qindra faqe dhe pastaj
2 askush nuk e di se çfarë është nxjerrë. D.m.th., për publikun
3 dhe për juve ky është shpjegimi, sepse debati deri tani ishte
4 debat shumë juridik.

5 Z. Von Bone, nuk e di a ka ndonjë gjë që doni të shtoni
6 për momentin pasi dëgjuan znj. Lawson? Dhe në qoftë se më
7 lejoni, do të doja të shtoja edhe diçka tjetër. Në qoftë se ka
8 punë ndërmjet palëve për këtë çështje, cila do të ishte --
9 cili do të ishte afati kohor për juve? D.m.th., ndoshta do të
10 ishte çështje ditësh për të gjetur një zgjidhje të pranueshme,
11 apo flitet për një zgjidhje prej disa javësh d.m.th., si e
12 shikoni ju këtë aspekt?

13 Z. VON BONE: [Përkthim] I nderuar Gjyqtar, për këtë
14 pjesë mendoj sinqerisht që ne për çështje ditësh mund ta
15 trajtojmë këtë gjë. Jam i disponueshëm për ta trajtuar këtë
16 çështje. Të punojmë së bashku dhe të gjejmë diçka që është
17 praktike jo vetëm ndërmjet palëve, por në fund edhe për
18 panelin gjyqësor që në një pikë të caktuar kohe do të duhet që
19 të ketë një pamje të qartë vizuale, ose do të duhet të dijë se
20 ku ta vendosë p.sh., këtë grup provash, apo sesi ta trajtojë
21 një grup tjetër provash.

22 Unë kam parë një dokument që është për një përmbledhje,
23 një tabelë e detajuar dhe që mua mu duk goxha e prezantueshme.
24 Megjithatë, në qoftë se ka ndonjë listë tjetër, në qoftë se ka
25 ndonjë tabelë që do ta kategorizonte këtë, ndoshta do të ishte

1 diçka e dobishme për t'u bërë. Siç e thashë dhe më sipër, ne
2 mund të identifikojmë, mund të gjejmë një lloj formati e mund
3 t'ia dërgojmë atë gjyqtarit të Seancës Paraprake, dhe në qoftë
4 se gjyqtari i Seancës Paraprake mendon se kjo është një
5 zgjidhje praktike dhe në qoftë se bie dakord me interpretimin
6 tonë në përkufizimin e termit "tabelë" apo "listë", atëherë
7 mund të vazhdojmë kështu në mënyrë që të mund të shmangim
8 ndonjë apelim.

9 Dhe mendoj që të dyja palët janë të interesuara që të
10 vijojmë me një proces gjyqësor të shpejtë, megjithëse ndoshta
11 çështjet e COVID-it mund të pengojnë disi hetimet tona, por
12 jam i sigurt që të dyja palët janë të interesuara në procese
13 të shpejta gjyqësore.

14 Shpresoj që gjyqtari i seancës të mund të gjejë një
15 opsion nën kuadrin e rregullave që unë përmenda pak më sipër,
16 edhe ndoshta që ta pezullojë pak urdhrin, për ca kohë, deri në
17 momentin që ne të gjejmë një zgjidhje, dhe pasi ta kemi gjetur
18 këtë zgjidhje ne do t'jua dërgojmë juve zoti Gjyqtar.

19 Sigurisht që unë i disponueshëm për të dhënë dhe një
20 zgjidhje, por në qoftë se do të më lejoni që të vijoj me
21 trajtimin e disa çështjeve të tjera.

22 Do të doja të thoja që Prokuroria në çdo rast ka më shumë
23 krah pune, ka më shumë persona ose staf sesa Mbrojtja. Është
24 barrë, por nga tjetër mund të them që këto lloj çështjes të
25 cilat janë ngritur nga Mbrojtja lidhen mbase jo me të njëjtën

1 numër çështjes që po trajton Prokuroria, sepse në fund fare
2 d.m.th., është Prokuroria që do të duhet që të kërkojë përtej
3 arsyes së -- përtej dyshimit të arsyeshëm le të themi, dhe
4 duhet që të jetë e aftë që të vërtetojë -- që vërteton akuzat
5 e veta përtej dyshimit të arsyeshëm, në mënyrë jo vetëm të
6 prezantueshme, por gjithashtu edhe në mënyrë të thjeshtë për
7 t'u interpretuar nga Mbrojtja dhe nga Trupi Gjykses.

8 Mendoj që si rezultat, urdhri mund të qëndrojë pezull
9 deri në momentin kur të kemi një lloj qartësimi, një lloj
10 precizoni të tij, ose deri sesa ai të ndryshohet për të mirën
11 e punës në të ardhmen, në mënyrë që të mund të shmangim
12 çështje procedurale të cilat mund të ngrihen në të ardhmen.
13 Unë nuk besoj që është një pikë shumë ekstreme parimi, nuk po
14 flasim për ndonjë parim shumë të vështirë, por është një
15 çështje parimi që ne do të duhet ta zgjidhim dhe është në dobi
16 të të dyja palëve në mënyrë që të kemi një proces gjyqësor të
17 shpejtë. Dhe jam absolutisht i sigurt që këtë kishit si synim
18 edhe ju i nderuar Gjyqtar që të realizonit nëpërmjet urdhrit
19 të nxjerrë, dhe shpresoj që nuk do të ketë probleme ndërmjet
20 palëve lidhur me këtë.

21 Thënë kjo, dua të them që pa diskutim që kërkohet goxha
22 punë, edhe megjithëse bëhet fjalë për shumë punë, një punë e
23 tillë mund të ndihmojë në fund pjesën tjetër të gjykimit, në
24 mënyrë që ky proces, kjo çështje të jetë më e shpejtë. Dhe
25 mendoj që është përgjegjësia e palëve gjithashtu që ta marrin

1 këtë përgjegjësi në duart e tyre dhe të thonë që "Këtë do të
2 bëjmë, dhe kjo është një mënyrë e dobishme e prezantimit",
3 kështu që gjatë gjithë procesit gjyqësor të gjitha palët mund
4 të gjejnë se në çfarë pike të shqyrtimit apo të ekzaminimit të
5 çështjes janë.

6 Ky është një proces gjyqësor kundër një personi të vetëm.
7 Nuk është një çështje me disa të akuzuar. Ndonjëherë mund të
8 ndodhi që të keni tre apo më shumë të akuzuar brenda një
9 çështje, por nuk është rast si ky, kështu do të thoja që barra
10 është relative. Por në qoftë se kjo është shumë më tepër sesa
11 mund të mbahet nga ana tjetër, atëherë do të duhet që të
12 gjendet një zgjidhje pune e përbashkët në mënyrë që të kemi
13 mundësinë që të vijojmë më tej.

14 Siç e thashë edhe më parë, depozitimet mund të jenë në
15 një Konferencë d.m.th., mund të jepen edhe në Konferencën e
16 Statusit, edhe jam i sigurt që gjyqtari do t'i shqyrtojë këto
17 çështje me kujdes dhe do të thotë se cilat janë zgjidhjet më
18 praktike për këtë çështje.

19 A ka ndonjë çështje tjetër që do të doja të trajtoja unë
20 për këtë moment? Për momentin nuk do të thoja që kam ndonjë
21 tjetër për të shtuar. Faleminderit për vëmendjen.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Von
23 Bone.

24 Mendoj që jemi të gjithë në të njëjtin drejtim. Jemi
25 dakord të gjithë se duam që të kemi nxjerrje që është edhe

1 efikase edhe sa më e detajuar të jetë e mundur, në mënyrë të
2 tillë që të gjithë të mund të kuptojnë çështjen. Mendoj që të
3 gjithë jemi në një linjë këtu.

4 Ajo çfarë duam të shmangim këtu dhe ajo çfarë dëgjojmë në
5 fakt nga Zyra e Prokurorit të Specializuar është që kjo
6 kërkesë nuk duhet që të jetë kundërproduktive, dhe me fjalë të
7 tjera d.m.th., mund të kërkohej kaq shumë punë për t'i bërë
8 këto tabela sa mund të ketë efektin e kundërt pra, mund të
9 shtojë më tepër punën.

10 Unë në fakt do të ndjek atë çfarë thatë juve pak më pas,
11 por do të doja së pari t'i bëja pyetjen znj. Lawson.

12 Së pari znj. Lawson, a mund të na thoni në qoftë se
13 çështja kryesore që keni ju është ideja e narratives, le të
14 themi në tabelë pra, skica e detajuar, përmbledhja e detajuar,
15 apo është parimi i prodhimit të listës? Kjo është pyetja e
16 parë.

17 Pyetja e dytë është kjo. Ju e dini që në "Legal Workflow"
18 që është një softuer që e përdorim ne për dokumente ligjore,
19 eksiton le të themi mundësia që të gjenerohet një tabelë
20 automatike në Eksel, në versionin Eksel. A është diçka që mund
21 ta përdorni ju kjo tabelë apo kjo listë? Megjithëse mund të
22 bëni disa ndryshime të vogla, në kuptimin që mund të shtoni
23 disa rreshta të tjerë, apo mund të hiqni informacione të
24 tjera. Dhe pyetja ime është në qoftë se do t'iu ndihmonte
25 punën në qoftë se do të gjeneronit automatikisht nga sistemi

1 onlain këtë listë, këtë tabelë.

2 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar. Pra, e
3 konfirmoj që nuk është çështje, ose parimi i listës apo i
4 tabelës.

5 Në fakt ajo çfarë kemi diskutuar ne me Mbrojtjen deri
6 tani është në listë apo në tabelë. Pjesa e narratives është
7 ajo na merr më shumë kohë, por ajo çfarë po flas -- për çfarë
8 po flasim neve është kategorizimi i dokumenteve në formatin e
9 listës ose të tabelës.

10 Sa i takon le të themi gjenerimit automatik të tabelave,
11 ne po shikojmë teknologjinë sesi ato mund të na ndihmojnë për
12 krijimin e listave të tilla dhe mund të jenë ndihmëse për të
13 dyja palët.

14 Sa i takon afatit kohor, siç e tha edhe Mbrojtja, mund të
15 konfirmoj që do t'ju drejtohem. Për disa ditë kemi pasur në
16 fakt disa biseda të cilat kanë qenë goxha konstruktive lidhur
17 me këtë temë.

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund
19 të bëj një pyetje tjetër. Sa kohë mendoni se ju duhen, sa ditë
20 ju duhen më specifikisht? Pra, bëhet fjalë për një javë, bëhet
21 fjalë për dy javë? Sepse nuk do të doja që një gjë e tillë të
22 mund të vononte procesin e nxjerrjes.

23 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E kuptojmë z. Gjyqtar. Mendojmë
24 që nuk do të jetë më shumë sesa një javë.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Atëherë, në qoftë se sot

1 jemi më datë 28 tetor, mendoni që e mërkura e javës tjetër do
2 të ishte afat kohor i arsyeshëm për juve?

3 ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Po pa diskutim. Ne do t'ju ishëm
4 drejtuar brenda asaj periudhe kohore dhe në qoftë se nuk do të
5 na kishit vendosur një afat.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë atëherë, do të jap
7 një urdhër me gojë për Zyrën e Prokurorit të Specializuar që
8 të na drejtohet me një propozim sa i takon tabelave të
9 nxjerrjes pas konsultimit me Mbrojtjen. Shpresoj të keni
10 mundësi që të bëni një propozim me të cilin do të bjerë dakord
11 dhe Mbrojtja ndërkohë, dhe në propozim do t'ju luteshim që të
12 shpjegonit dhe se çfarë tabele apo çfarë liste do të keni
13 mundësi që të prodhoni, çfarë lloj informacioni do të fusni në
14 një dokument të tillë. Dhe në qoftë se do ta bënit këtë gjë,
15 atëherë do të na ndihmonit goxha besoj.

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të
17 shtoj diçka i nderuar zoti Gjyqtar?

18 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Po.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Shpresoj që tabela apo lista të
20 mund të bëhet një dokument që është në ndryshim e sipër, në
21 kuptimin që herë pas herë ne mund të bëjmë ndryshim të tabelës
22 apo të listës edhe të themi që ajo do të jetë kuadri ligjor,
23 dhe pastaj në qoftë se do të na duhet që të shtojmë gjëra të
24 tjera të mund ta bëjmë këtë gjë me kalimin e kohës. D.m.th.,
25 në qoftë se do të na e lejonit këtë gjë dhe në qoftë se do të

1 ishte e mundur që ta shikonim si instrument pune, si
2 instrument në ndryshim, jo si një tabelë të fiksuar ku nuk
3 mund të ndryshonim asnjë lloj gjëje. Mendoj që kjo do të na
4 vinte në ndihmë goxha neve, të dyja palëve. Kështu që ky ishte
5 komenti që kisha për të bërë për juve i nderuar zoti Gjyqtar.

6 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit Mbrojtës.

7 Atëherë, sa i takon afatit të nesërm, do të doja t'i
8 drejtohesha Zyrës së Prokurorit të Specializuar që të mos e
9 mbani parasysh urdhrin për ditën e nesërme dhe besoj që pas
10 këtij diskutimi sot pra, nuk është e rëndësishme që të
11 respektoni afatin e urdhrit për nesër.

12 Nuk e di në qoftë se keni ndonjë gjë tjetër për këtë
13 çështje znj. Lawson apo z. Von Bone? Mirë faleminderit.

14 Tani do të vazhdojmë me agjendën për ditën e sotme për
15 Konferencën e Statusit.

16 Pra, e shoh që nuk janë depozituar parashtresa me shkrim
17 nga asnjëra nga palët, dhe shpresoj që kjo të shpjegohet apo
18 të nënkuptoj se çdo gjë ka vajtur siç duhet me procesin e
19 nxjerrjes.

20 Edhe siç e thashë edhe më përpara, qëllimi sot është që
21 të rishikohet statusi i çështjes, të organizohen shkëmbimet
22 ndërmjet palëve në mënyrë që të mund të bëhen përgatitje të
23 shpejta për procesin në vijim.

24 Do të doja që t'ju kërkoja palëve që të jepnin
25 parashtrimet e tyre, dhe do të doja që t'ju kërkoja palëve që

1 në qoftë se do të nxjerrin informacion konfidencial në
2 parashtrimet e tyre të na e thonë këtë gjë në mënyrë që të
3 mund të kalojmë në seancë me dyer të mbyllura.

4 Zëri i parë është -- janë vështirësitë për nxjerrjen.
5 Kështu që do të doja që së pari t'i jap fjalën Prokurorisë për
6 këtë pikë në agjendë, për të na thënë në qoftë se ka pasur
7 vështirësi për procesin e nxjerrjes së informacionit.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit shumë zoti
9 Gjyqtar.

10 Ne nuk kemi vështirësi për momentin sa i takon procesit
11 të nxjerrjes së materialeve. Të premtën e shkuar, më datë 23
12 tetor, neve i nxorëm Mbrojtjes paketën e nxjerrjes numër 8, që
13 përfshinte 82 prova materiale, përfshirë këtu edhe dëshmitë e
14 dhëna nga dëshmitarët. Po ashtu kemi dhënë informacion në një
15 format të redaktuar, siç kërkohej në kuadër të vendimit Kuadër
16 të dhënë prej jush zoti Gjyqtar. Pra, ne kemi respektuar
17 rregullën numër 102(1) ndërkohë që e kemi bërë këtë gjë.

18 Pra, të njëjtën ditë, të premtën e shkuar, më datë 23
19 tetor, ne kemi nxjerrë paketën numër 9, mbështetur në
20 rregullën 102(3). Ne kemi diskutuar në fakt për nxjerrjen e
21 këtij dokumenti, që është një libër, është një libër i cili
22 është në gjuhën shqipe që është përkthyer në anglisht. Edhe në
23 fakt e kemi diskutuar këtë çështje më datën 5 tetor, datën kur
24 u organizua Konferenca e Parë e Statusit dhe kjo është diçka
25 që është bërë që prej atëherë.

1 I kemi dërguar gjithashtu një i-mal Mbrojtjes në të
2 njëjtën datë, që është data 23 tetor gjatë paradites, ku kemi
3 shpjeguar në detaje paketat me informacion që kemi zbuluar apo
4 kemi nxjerrë të njëjtën ditë.

5 Kur flitet për vështirësitë, e vetmja vështirësi që mund
6 të hasim sa i takon nxjerrjes dhe ndikimit të afateve kohore,
7 në fakt ajo u diskutua pak minuta më përpara ndërmjet
8 Mbrojtjes edhe Zyrës së Prokurorit së Specializuar dhe jush i
9 nderuar zoti Gjyqtar, sa i takon ofrimit të tabelave apo
10 listave. Kjo është çështja më e rëndësishme për momentin. Dhe
11 shpresojmë që kjo mos të ketë ndonjë ndikim në qoftë se
12 diskutimet tona do të jenë pa probleme dhe në qoftë se nuk
13 kemi pengesa të tjera.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Mirë, faleminderit.

15 Z. Von Bone, nuk e di nëse keni ndonjë koment lidhur me
16 këtë, ose në qoftë se keni hasur ndonjë vështirësi me procesin
17 e nxjerrjes së informacionit?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo në veçanti, jo me aq sa mund
19 t'ju them. Megjithatë, mund t'ju them që nuk kam pasur mundësi
20 që të rishikoj, të analizoj të gjithë dokumentet që më janë
21 vënë në dispozicion deri tani. Nuk jam i sigurt në qoftë se
22 ato janë përkthime të gjuhës shqipe.

23 D.m.th., librin e kam parë, e kam lexuar versionin në
24 anglisht, por shpresoj që të gjitha provat të cilat do të
25 përdoren në këtë proces gjyqësor si prova dhe që kanë të bëjnë

1 me klientin tim dhe që do të mbështesin padi ose akuza të
2 ndryshme, prova të caktuara do të duhet pa diskutim të jenë në
3 gjuhën shqipe në mënyrë që mund të lexohen nga i akuzuari,
4 sepse pra, shqipja ime është joekzistente. Kështu që për këtë
5 arsye është shumë e rëndësishme që gjëra të caktuara të mund
6 t'i diskutoj me klientin tim dhe ai të ketë versionet në shqip
7 të provave.

8 Nuk kam pasur mundësi që t'i futem në detaje, le të themi
9 dosjeve që më janë dhënë, por në qoftë se ka ndonjë çështje
10 shqetësuese ne kemi një rrugë komunikimi të përbashkët. Pra,
11 mund të komunikojmë përmes i-maileve, mund të shkruaj numrat
12 ERN që janë numrat identifikues të dokumenteve, edhe mund të
13 kërkoj në qoftë se dokumente të caktuara janë të disponueshme
14 në gjuhën shqipe.

15 Kështu që gjëra të tilla, të kësaj natyre do të mundohem
16 që t'i menaxhoj në këmbimin apo në komunikimin e
17 drejtpërdrejtë me Zyrën e Prokurorisë.

18 Deri në këtë moment nuk është se kam pasur ndonjë çështje
19 shqetësuese. Megjithatë, do të doja që të theksoja edhe
20 njëherë tjetër për Zyrën e Prokurorisë së Specializuar, se
21 është absolutisht shumë e rëndësishme për klientin tim që të
22 gjithë materialet ai t'i marrë në gjuhën shqipe për aq kohë sa
23 dokumentet do të përdoren në mbështetje të akuzave kundër tij.

24 Faleminderit. Kaq kisha për të thënë për momentin.

25 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit shumë z. Von

1 Bone.

2 Z. Prokuror, dëshiron që të shtosh ndonjë gjë lidhur me
3 pyetjen që ka të bëjë me përkthimin?

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni z.
5 Gjyqtar, dua të them që i kuptoj plotësisht shqetësimet e
6 Mbrojtjes lidhur me këtë çështje, dhe do të doja t'ju
7 informoja si juve dhe avokatin Mbrojtës që paketat e zbuluara
8 apo të nxjerra janë dhënë të plota në gjuhën shqipe.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit. E mbajtëm
10 shënim.

11 Tani kalojmë te pika e dytë e Konferencës së Statusit që
12 janë hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

13 Z. Prokuror, do të doja që t'ju pyesja për statusin apo
14 gjendjen e hetimeve tuaja. Në veçanti do të doja të dija në
15 qoftë se i keni përfunduar hapat hetues të cilat u përmendën
16 në Konferencën e parë të Statusit, dhe në qoftë se mund të na
17 jepni një datë të paralajmëruar apo të menduar për përfundimin
18 e hetimeve?

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po z. Kryetar. Faleminderit.
20 Përgjigjja e shkurtër për pyetjen tuaj është jo, nuk i kemi
21 përfunduar hetimet. Ka disa aktivitete të kufizuara të cilat
22 janë ende pezull. Ne nuk duam që të angazhohemi për një afat
23 kohor të veçantë kur flitet për përfundimin e këtyre hetimeve.

24 Megjithatë, do të doja ta bëja absolutisht të qartë se
25 hetimet tona, hetimet që ne po realizojmë, dhe po flasim këtu

1 vetëm për hetime të kufizuara, ato nuk kanë ndikim në asnjë
2 mënyrë mbi afatet kohore të cilat janë përcaktuar nga ju i
3 nderuar z. Gjyqtar, afate të cilat janë shumë të rëndësishme
4 për ne.

5 Kështu që, siç e thashë edhe më parë, ne nuk është se do
6 të hetojmë shumë duke filluar nga tani e në vijim. Megjithatë,
7 në qoftë se do të ketë hapa të tjerë hetues të cilat do të
8 duhet të ndërmerren në një fazë të mëvonshme të cilat shkojnë
9 përtej afatit të nxjerrjes, sigurisht që do t'ju informojmë
10 ju, i nderuar z. Kryetar, për nevojat përkatëse. Dhe sigurisht
11 që ne do t'i realizojmë hetimet tona shtesë në përputhje të
12 plotë me Rregulloren dhe me ligjet në fuqi.

13 Faleminderit shumë.

14 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, a keni ndonjë
15 gjë për shtuar rreth kësaj pike?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kam.

17 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

18 Z. Prokuror, kur thoni "hetime shtesë", a bëhet fjalë për
19 javë apo muaj për sa i përket kuadrit kohor? E kam të qartë se
20 për shkak të COVID-it është e vështirë që të caktohet një
21 afat, por thjesht për të pasur një ide të përgjithshme sesa
22 kohë mund të marrë kjo.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Siç ju thashë i nderuari
24 Gjykatës, nuk dua që të zotohem për një afat kohor të caktuar
25 sepse për ne është e vështirë për arsye të COVID-it, por edhe

1 për arsye të tjera që janë jashtë kontrollit të ZPS-së dhe që
2 mund të ndikojnë në shtrirjen e hetimit. Siç thashë, këto
3 hetime janë të kufizuara për kah fushëveprimi dhe ne do të
4 përpiqemi t'i përfundojmë të gjitha hapat hetimorë sa më
5 shpejtë që është e mundur. Edhe njëherë theksoj se këto hetime
6 nuk do të keni kurrfarë ndikimi mbi afatet e nxjerrjes së
7 materialeve.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Kam marrë shënim atë që
9 thatë.

10 Tani do të ngre çështjen e dosjes paragjyqësore.

11 Z. Prokuror, a mund të më thoni se kur përafërsisht do të
12 jeni në gjendje të dorëzoni dosjen paragjyqësore dhe të gjitha
13 materialet paraprake në përputhje me rregullën 95. Në qoftë se
14 mund të caktoni një afat të tillë, duke marrë parasysh
15 kalendarin e afateve të caktuara për këtë çështje.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës. Lidhur me
17 këtë në fakt kemi kalendarin e nxjerrjes së materialeve që e
18 keni caktuar ju dhe afatet shkojnë deri në janar të vitit
19 2021. Ne do të përpiqemi dhe do të bëjmë ç'është e mundur që
20 të dorëzojmë dosjen paragjyqësore dhe materiale të tjera
21 paraprake deri nga fundi i shkurtit të vitin 2021. Gjithsesi
22 dua që fillimisht t'i kryejmë të gjitha detyrimet tona të
23 nxjerrjes së materialeve përpara se të dorëzojmë çështjen --
24 dosjen paragjyqësore.

25 Ky indikim i kohës pra, shkurt 2021 është vetëm një

1 indikim, se kjo datë mund të lëvizë qoftë përpara apo mbrapa
2 varësisht nga rrethanat. Gjithashtu edhe Mbrojtja duhet të
3 bëjë disa hapa të tjera, dhe pas këtyre hapave ne do ta dimë
4 se kur mund të dorëzojmë dosjes paragjyqësore.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

6 Z. Von Bone, a keni ndonjë gjë për të shtuar lidhur me
7 këtë?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kam. Ju faleminderit.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Për pikën tjetër në rendin
10 e ditës, do t'i drejtohem së pari Mbrojtjes.

11 Z. Von Bone, në bazë të informacionit që ka dhënë
12 Prokurori lidhur me pika të tjera të agjendës dhe kalendarit
13 të paraqitjes së materialeve, a jeni në gjendje të na jepni
14 informacion për sa i përket si vijon, së pari, statusit të
15 hetimeve tuaja; e dyta, në qoftë se keni ndërmend të bëni
16 njoftim për alibi ose për arsye të tjera që përjashtojnë
17 përgjegjësinë në bazë të rregullës 95, ose çfarëdo nxjerrje
18 tjetër në këtë drejtim në bazë të rregullës 104; dhe tre, në
19 qoftë se keni ndërmend të bëni kërkesa për mundësi hetimore
20 unike në bazë të rregullës 99?

21 E keni fjalën.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës, kam disa
23 fjalë për të thënë lidhur me këtë.

24 Për sa i përket statusit të hetimeve të Mbrojtjes, mund
25 t'ju them shkurt se pothuajse nuk kemi filluar. Problemi është

1 çështja e COVID-it dhe gjendjes rreth COVID-it në Holandë. Dje
2 kishim deklaratën e ministrit të Shëndetësisë së Holandës dhe
3 u njoftuam se masat që janë marrë në këtë pikë kohore do të
4 jenë në fuqi deri nga fundi i dhjetorit. Kjo nuk e bën të
5 lehtë punën e hetimit. Pra, në kuptim të kontaktimit të
6 dëshmitarëve, intervistimit të tyre apo intervistimit të
7 ekspertëve, apo punës në terren.

8 Kosova në këtë moment është e shënuar me ngjyrën
9 portokalli për nga epidemia e COVID-it pra, është rajon i
10 shënuar me ngjyrë portokall dhe është si të thuash në gjendje
11 më të mirë se Holanda e cila është e shënuar me të kuqe në
12 këtë moment. Pra, karantina parashtron probleme në këtë
13 moment, por parashikoj që në të ardhmet do të mund të kryej
14 një mision dhe më pas t'ju njoftoj për statusin e hetimeve të
15 Mbrojtjes.

16 Për sa i përket njoftimit për alibi, ose për arsye të
17 tjera që përjashtojnë përgjegjësinë, në këtë pikë kohore për
18 mendimin e Mbrojtjes është herët që të jepet një njoftim i
19 tillë. Në këtë moment nuk kemi për të bërë nxjerrje
20 materialesh në bazë të rregullës 104(1) dhe 104(2) të
21 Rregullores. Këtë do ta bëjmë në të ardhmen. Në këtë moment
22 nuk mund të bëj -- të caktoj një kuadër kohor apo afate si të
23 thuash.

24 Për sa i përket mundësisë hetimore unike, në bazë të
25 rregullës 99, në këtë moment e di që nuk kam një kërkesë

1 konkrete në këtë drejtim. Kjo padyshim që lidhet me hetimet e
2 tjera që përpiqemi t'i kryejmë, dhe për atë arsye kjo do të
3 kërkojë më shumë kohë se hetime të tjera fillestare që do t'i
4 bëjmë.

5 Në këtë pikë -- moment, nuk mund të t'ju them asgjë
6 tjetër i nderuar Gjykatës, por sigurisht që do ta bëj këtë në
7 Konferencës tjetër të Statusit të Ecurisë së Çështjes.

8 Se me kohë Mbrojta do të ketë një ide më të mirë për të
9 gjithë misionin e saj. Përgatitjet janë në kryerje e sipër,
10 por për të bërë një kërkesë të tillë duhet të bëj, caktoj
11 afatin kohor që do të më duhet, dhe ky afat është të paktën 14
12 ditë. Besoj që deri atëherë do të jem në misionin tim të parë
13 dhe do të kem rezultatet e para.

14 Në qoftë se p.sh., seancën tjetër të Ecurisë së Çështjes
15 do ta caktonim mbas katër javësh, unë me siguri që nuk do të
16 jem këtu dhe nuk do të jem në gjendje të marrë në këtë seancë
17 -- në atë seancë të Statusit. Për mendimin tim është më mirë
18 që të kemi një Konferencë Statusi diku në dhjetor dhe jo në
19 nëntor.

20 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Von
21 Bone.

22 I kuptoj plotësisht kufizimet me të cilat përballeni.
23 Thjesht kur ta keni të ditur se doni të ngrini ndonjërin prej
24 këtyre çështjeve, sidomos për njoftimin për alibi, ju lutem ta
25 bëni këtë në mënyrë që të mos i vonojmë procedurat.

1 Siç thashë, ju kuptoj plotësisht se nuk jeni në gjendje
2 ta bëni këtë në këtë moment, por posa të jeni në gjendje ta
3 bëni këtë, ju lutem t'i drejtoheni gjykatës.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Po, do ta bëj këtë.

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Faleminderit.

6 Z. Prokuror, a keni diçka për të shtuar lidhur me këtë
7 pikë?

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo. Ju faleminderit. S'kemi
9 asgjë për të shtuar.

10 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

11 Tani, a ka ndonjëra prej palëve për të ngritur ndonjë
12 çështje të cilën nuk e kemi trajtuar sot, nuk e kemi ngritur
13 sot? A keni ndonjë pikë specifike që doni të ngrini në këtë
14 moment?

15 Z. Prokuror?

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk jemi duke diskutuar tani
17 pikë -- kohën e përshtatshme për Konferencën e ardhshme të
18 Statusit?

19 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Jo. Nëse keni ndonjë gjë
20 tjetër për të ngritur në këtë moment.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të konsultohem njëherë me
22 kolegun tim ju lutem.

23 [Prokurori konsultohet me kolegun]

24 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nuk kemi
25 asgjë për të ngritur në këtë moment.

1 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

2 Do të presim ca minuta në mënyrë që z. Von Bone të mund
3 të diskutojë diçka me klientin e vetë. Urdhëroni z. Von Bone.

4 [Avokati Mbrojtës konsultohet me të akuzuarin]

5 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Ju faleminderit i nderuar
7 Gjykatës. Nuk kemi asnjë çështje tjetër për të ngritur.

8 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

9 Tani, pika e fundit është data e Konferencës së ardhshme
10 të Ecurisë së Çështjes.

11 Z. Prokuror, a keni ndonjë propozim për datën që do të
12 ishte më e përshtatshme për mbajtjen e asaj seance?

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Lidhur me Vendimin Kornizë për
14 Nxjerrjen e Materialeve, Prokurori ka një detyrim që është 1
15 dhjetori. Deri atëherë duhet të jemi -- kemi detyrimin e
16 nxjerrjes së një njoftimi të hollësishëm për provat sipas
17 rregullës 102(3) të Rregullores. Në qoftë se ky afat ende
18 qëndron, atëherë propozoj që ta mbajmë Konferencën e ardhshme
19 në dhjetor dhe jo në nëntor. Mirëpo në qoftë se Mbrojtësi apo
20 ju i nderuar Gjykatës, doni që të mblihdemi për një seancë të
21 tillë në nëntor, atëherë ne nuk do të kemi kundërshtime.

22 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Z. Von Bone, edhe ju më
23 duket që thatë se dhjetori duket sikur -- muaji më i mirë për
24 mbajtjen e Konferencës së ardhshme të Ecurisë.

25 Z. VON BONE: [Përkthim] Në qoftë se është e mundur para

1 -- jo para datës 9 dhjetor dhe sigurisht jo më datën 16
2 dhjetor ju lutem. Kam një çështje tjetër personale në atë
3 ditë.

4 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit z. Von
5 Bone.

6 Përpara se të përfundojmë, z. Mustafa a keni ndonjë
7 koment lidhur me kushtet e paraburgimit?

8 I AKUZUARI: Jo i nderuar Gjykatës. Mirë.

9 GJYKATËSI GUILLOU: [Përkthim] Ju faleminderit.

10 Me kaq përfundoj seancën e sotme. Falënderoj palët,
11 Sekretarinë për praninë e tyre. Falënderoj përkthyesit,
12 stenografët, teknikët dhe personelin e sigurisë. Këtu
13 përfundon seanca.

14 --- Konferenca për Ecurinë e Çështjes përfundon në
15 orën 16.18

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25